



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 359/12 Prot.,

Datë 31.03.2026

V E N D I M
Nr. 447 / 2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.03.2026 me

Objekt: Anulimin e procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” me Nr. REF-65137-10-15-2025, me objekt: Shërbim printimi: me fond limit 2,500,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.12.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

Ankimues: Operatori ekonomik “PC STORE” ShPK, me Nipt L01606034A. Adresa: Rruga e Dibrës, vila 153, kati 1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Himarë.
Adresa: Rr. “25 Marsi”, nr.2; Spile, Himarë.

Subjekt i Ineresuar \ Operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK, me Nipt J62426002Q, Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Kodër Kashar, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datë 16.12.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Shërbim, me Nr. REF-65137-10-15-2025, me objekt: Shërbim printimi: me fond limit 2,500,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.12.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

II.2 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), rezulton se autoriteti kontraktor në datën 29.12.2025 ka zhvilluar procedurën e prokurimit dhe më datë 21.01.2026 ka përfunduar vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe renditjen e tyre në SPE, më poshtë vijon:

Operatorët ekonomikë	Vlerat e ofertave	Vlerësimi
1- InfoSoft Office ShPK	2,925,600	Kualifikuar
2- PC STORE ShPK	3,381,000	Kualifikuar

II.3. Nga verifikimet e kryera në SPE, Autoriteti Kontraktor më datë 29.01.2026 ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraparak për procedurën e prokurimit.

II.4 Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6304, datë 04.02.2026 dhe me nr. 359/2026 prot., datë 04.02.2026 e operatorit ekonomik “PC STORE” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-65137-10-15-2025, me objekt: Shërbim printimi: me fond limit 2,500,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.12.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.5 Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin e publikimit nr. 359/1 prot., datë 05.02.2026, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë.

Konkretisht objekti i pretendimeve në ankesë është si vijon:

“[...]AK Bashkia Himarë në datën 16.12.2025, për nevojat e tij, ka publikuar në SPE procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim printimi”, me fond limit: 2,500,000 (dy milion e pesëqindë mijë lekë) pa TVSH. Data e fundit për paraqitjen e ofertave ishte data 26.12.2025, e cila u përcaktua si ditë pushimi me VKM. Përkundër parashikimeve ligjore, AK ka vijuar me hapjen e ofertave me datë 26.12.205 dhe në datën 21.01.2026 ka proceduar me publikimin e renditjes/klasifikimit dhe në datën 29.01.2026 ka vijuar me njoftimin paraprak të fituesit. Duke qenë se në datën 29.01.2026 është shpallur fituesi paraprak, njëkohësisht lind e drejta e ankimit për operatorët ekonomikë të interesuar, në mbështetje të nenit 110 “Afatet për ankim” pika 2 të LPP. Theksojmë se procesi i vlerësimit të ofertave nga Autoriteti Kontraktor, sipas gjykimit tonë, përbën një akt administrativ të paligjshëm dhe të parregullt. AK nuk ka zbatuar detyrimet që përcakton legjislacioni për prokurimin publik në lidhje me procedurat dhe afatet në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik. Konkretisht, AK Bashkia Himarë kishte përcaktuar që data e fundit për paraqitjen e ofertës ishte data 26.12.2025. Ndërkohë, Këshilli i Ministrave në mbledhjen e radhës më përpara kësaj date, ndër të tjera, vendosi që dita e premte datë 26.12.2025 do të jetë ditë pushimi zyrtar. Këshilli i Ministrave e caktoi datën 26.12.2025, përmes vendimit Nr. 782, datë 24.12.2025 “PËR CAKTIMIN E DITËS SË PREMTE, DATË 26.12.2025, DITË PUSHIMI”, ku shprehet se, citoj: Në mbështetje të neneve 95, pika 2, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave Vendosi:1.Caktimin e ditës së premte, datë 26.12.2025, ditë pushimi për punonjësit e administratës shtetërore. 2. Dita e punës, e datës 26.12.2025, do të zëvendësohet në një nga ditët e pushimit brenda tremujorit të parë të vitit 2026. 3. Ngarkohen institucionet e administratës shtetërore për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare. Ky vendim u botua në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë Nr. 242, Datë. 24/12/2025 dhe hyn në fuqi menjëherë. Pra, AK Bashkia Himarë ka vijuar me hapjen dhe shqyrtimin e ofertave në datë 26.12.2025, megjithëse data 26.12.2025 ishte caktuar me VKM ditë pushimi zyrtar. Ky veprim i AK Bashkia Himarë bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik dhe në kundërshtim të hapur me Udhëzimin Nr. 01 datë 30.06.2025 “PËR MËNYRËN E ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT ME MJETE ELEKTRONIKE”: “Gjithashtu, theksojmë se, afati i fundit për pranimin e oferta në asnjë rast nuk duhet të përkojë në ditë feste zyrtare apo në ditë pushimi.” Në këtë kuptim, procedura e prokurimit publik objekt ankimi duhet anuluar nga Komisioni i Prokurimit Publik në bazë nenit 98, pika 1 shkronja d e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar.

Për sa kemi paraqitur më sipër, në dritën e fakteve, bazuar në legjislacionin përkatës, përfundimisht kërkojmë: 1. Pezullimin e procedurës së prokurimit. 2. Anulimin e procedurës së prokurimit publik nr REF-65137-10-15-2025 me objekt “Shërbim printimi” e zhvilluar në datën 26.12.2025 nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Himarë. [...]

II.6. Me shkresën ardhur në Sistem protokolluar me tonën me nr. 359/2, datë 10.02.2026, me objekt “Formular Argumentesh”, operatori ekonomik i interesuar InfoSoft Office ShPK ka kundërshtuar ankesën [...]Kjo ankesë çënon interesat e shoqërisë InfoSoft Office SHPK, e

cila është e shpallur paraprakisht fituese e procedurës së prokurimit, objekt i këtij ankimi, në zbatim të pikës 1 të nenit 113, e Ligjit Nr. 162/2020, Për Prokurimin Publik i ndryshuar, brenda afatit 5 ditë nga publikimi nga KPP-ja të arsyeve të skualifikimit të ekonomik ankimues, Ju parashtrajmë argumentat tona kundërshtuese përsa i përket ankesës elektronike A/2026/6304, datë 04.02.2026 dhe me nr. 359/2026 prot., datë 04.02.2026 e operatorit ekonomik PC STORE SHPK, si dhe arsyet ligjore ku bazohen këto argumenta: ankimuesi nuk ka qenë i dëmtuar apo i rrezikuar të dëmtohej nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi... ndaj duhet të refuzohet ankesa me nr 359/2026 prot., datë 04.02.2026 e operatorit ekonomik "PC STORE" ShPK [...]

II.7. Me shkresën me Nr. 359/3 prot., datë 16.02.2026, drejtuar Autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi informacion mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik "PC STORE" ShPK për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.8. Me shkresën me Nr. 359/4 prot., datë 24.02.2026, drejtuar Autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik rikërkoi informacion mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik "PC STORE" ShPK për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.9 Me shkresën ardhur me shërbim postar me nr.621/13 prot, datë 26.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 359/5, datë 02.03.2026 autoriteti kontraktor ka përcjellë Vendimin e KSHA-së në lidhje me shqyrtimin e ankesës.

Referuar Vendimit Nr.621/12 Prot., datë 26.02.2026 të KSHA-së, autoriteti kontraktor ka vendosur praninë të pretendimeve të ngritura në ankesë duke vendosur anulimin e procedurës së prokurimit.

II.10. Me shkresën me Nr. 359/6 prot., datë 03.03.2026, drejtuar Autoritetit Kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi informacion si vijon:

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar Formulari paraqitjes së argumenteve nga operatori ekonomik i interesuar "InfoSoft Office" ShPK, për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur e Thjeshtuar" me Nr. REF-65137-10-15-2025, me objekt: Shërbim printimi: me fond limit 2,500,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.12.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

Referuar dokumentit operatori i interesuar "InfoSoft Office" ShPK kundërshton ankesën A/2026/6304, datë 04.02.2026 dhe me nr. 359/2026 prot., datë 04.02.2026 e operatorit ekonomik "PC STORE" ShPK për procedurën e prokurimit, në referim të nenit 113 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor përcjellë pranë KPP-së me shkresën nr. 621/13 Prot., datë 26.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 359/5, datë 02.03.2026 vërehet se KSHA ka trajtuar ankesën dhe ka marrë vendim nr. 3, datë 26.02.2026 në lidhje me pretendimet e ngritura nga operatorit ekonomik "PC STORE" ShPK.

Përsa referuar, në bazuar të neni 113 dhe 114 pika 4 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Komisioni kërkon të informoni dhe vërtetonin për sa vijon:

- 1. A keni njoftuar operatorin ekonomik "InfoSoft Office" ShPK mbi vendimmarrjen e autoritetit tuaj kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës sipërcituar.*
- 2. Nëse po, ju lutem të na dërgoni kopje të librit të protokollit që vërteton dërgimin dhe marrjes e vendimit nga operatori i interesuar.*

Me qëllim vijimin e shqyrtimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duhet të dërgoni pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar, brenda dy ditësh nga marrja e kësaj shkrese.

II.11. Me shkresën ardhur me shërbim postar me nr.621/6 prot, datë 13.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 359/7, datë 19.03.2026 autoriteti kontraktor informon se ka përcjellë vendimin e KSHA-së për operatorin ekonomik të interesuar “InfoSoft Office” ShPK, vërtetuar me fotokopje të Regjistrimit të dorëzimit në Postë.

II.12. Me shkresën me nr. 359/8 Prot., datë 26.03.2026, drejtuar operatorit ekonomik të interesuar “InfoSoft Office” ShPK “Komisioni kërkon:

[...] të informohet nga ju, në cilësinë e subjektit të interesuar në kuptim të nenit 113 të LPP-së, mbi datën në të cilën keni marrë dijeni mbi vendimmarrjen e autoritetit kontraktor për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik PC STORE ShPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, të shoqëruar me dokumentacion provues.

Me qëllim vijimin e shqyrtimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duhet të dërgoni pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar ..[...]

II.13. Me shkresë ardhur protokolluar me tonën me Nr. 359/19, datë 31.03.2026, operatori ekonomik i interesuar “InfoSoft Office” ShPK informon: *[...] Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se shkresa me Nr. 621/5, datë 11.03.2026 ka mbërritur pranë zyrave tona me anë të Posta Shqiptare me datë 13.03.2026. Bashkëlidhur kopje e librit të postës për marrje në dorëzim nga “InfoSoft Office” ShPK, të dokumentit.[...]*

III

Komisioni i Prokurimit Publik,

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë, operatori ekonomik “PC STORE” ShPK kundërshton zhvillimin e procedurës së prokurimit si vijon:

“[...]AK Bashkia Himarë në datën 16.12.2025, për nevojat e tij, ka publikuar në SPE procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim printimi”, me fond limit: 2,500,000 (dy milion e pesëqindë mijë lekë) pa TVSH. Data e fundit për paraqitjen e ofertave ishte data 26.12.2025, e cila u përcaktua si ditë pushimi me VKM. Përkundër parashikimeve ligjore, AK ka vijuar me hapjen e ofertave me datë 26.12.2025 dhe në datën 21.01.2026 ka proceduar me publikimin e renditjes/klasifikimit dhe në datën 29.01.2026 ka vijuar me njoftimin paraprak të fituesit. Duke qenë se në datën 29.01.2026 është shpallur fituesi paraprak, njëkohësisht lind e drejta e ankimit për operatorët ekonomikë të interesuar, në mbështetje të nenit 110 “Afatet për ankim” pika 2 të LPP. Theksojmë se procesi i vlerësimit të ofertave nga Autoriteti Kontraktor, sipas gjykimit tonë, përbën një akt administrativ të paligjshëm dhe të parregullt. AK nuk ka zbatuar detyrimet që përcakton legjislacioni për prokurimin publik në lidhje me procedurat dhe afatet në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik. Konkretisht, AK Bashkia Himarë kishte përcaktuar që data e fundit për paraqitjen e ofertës ishte data 26.12.2025. Ndërkohë, Këshilli i Ministrave në mbledhjen e radhës më përpara kësaj date,

ndër të tjera, vendosi që dita e premte datë 26.12.2025 do të jetë ditë pushimi zyrtar. Këshilli i Ministrave e caktoi datën 26.12.2025, përmes vendimit Nr. 782, datë 24.12.2025 “PËR KAKTIMIN E DITËS SË PREMTE, DATË 26.12.2025, DITË PUSHIMI”, ku shprehet se, citoj: Në mbështetje të neneve 95, pika 2, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave Vendosi:1.Caktimin e ditës së premte, datë 26.12.2025, ditë pushimi për punonjësit e administratës shtetërore. 2. Dita e punës, e datës 26.12.2025, do të zëvendësohet në një nga ditët e pushimit brenda tremujorit të parë të vitit 2026. 3. Ngarkohen institucionet e administratës shtetërore për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare. Ky vendim u botua në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë Nr. 242, Datë. 24/12/2025 dhe hyn në fuqi menjëherë. Pra, AK Bashkia Himarë ka vijuar me hapjen dhe shqyrtimin e ofertave në datë 26.12.2025, megjithëse data 26.12.2025 ishte caktuar me VKM ditë pushimi zyrtar. Ky veprim i AK Bashkia Himarë bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik dhe në kundërshtim të hapur me Udhëzimin Nr. 01 datë 30.06.2025 “PËR MËNYRËN E ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT ME MJETE ELEKTRONIKE”: “Gjithashtu, theksojmë se, afati i fundit për pranimin e oferta në asnjë rast nuk duhet të përkojë në ditë feste zyrtare apo në ditë pushimi.”.

Për sa kemi paraqitur më sipër, në dritën e fakteve, bazuar në legjislacionin përkatës, përfundimisht kërkohet: 1. Pezullimin e procedurës së prokurimit. 2. Anulimin e procedurës së prokurimit publik nr REF-65137-10-15-2025 me objekt “Shërbim printimi” e zhvilluar në datën 26.12.2025 nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Himarë. [...]

III.1.1. Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në Sistem Formularin për Publikim nr. 359/1 prot., datë 05.02.2026, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë.

III.1.2. Me shkresën ardhur në Sistem protokolluar me tonën me nr. 359/2, datë 10.02.2026, me objekt “Formular Argumentesh”, operatori ekonomik i interesuar InfoSoft Office ShPK ka kundërshtuar ankesën [...]Kjo ankesë çënon interesat e shoqërisë InfoSoft Office SHPK, e cila është e shpallur paraprakisht fituese e procedurës së prokurimit, objekt i këtij ankimi, në zbatim të pikës 1 të nenit 113, e Ligjit Nr. 162/2020, Për Prokurimin Publik i ndryshuar, brenda afatit 5 ditë nga publikimi nga KPP-ja të arsyeve të skualifikimit të ekonomik ankimues, Ju parashtrorjmë argumentat tona kundështuese përsa i përket ankesës elektronike A/2026/6304, datë 04.02.2026 dhe me nr. 359/2026 prot., datë 04.02.2026 e operatorit ekonomik PC STORE SHPK, si dhe arsyet ligjore ku bazohen këto argumenta: ankimuesi nuk ka qenë i dëmtuar apo i rrezikuar të dëmtohej nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi... ndaj duhet të refuzohet ankesa.

Referuar afateve kohore të paraqitjes së Argumenteve, rezulton se Operatori ekonomik i interesuar në këtë procedurë prokurimi ka respektuar afatin 5 ditor të paraqitjes së argumenteve, në përputhje me nenin 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si edhe me nenin 99, të VKM-së 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë. Paraqitja e argumenteve bëhet në Sistemin e Ankesave Elektronike.

III.1.3. Autoriteti kontraktor ka përcjellë Vendimin Nr.621/12 Prot., datë 26.02.2026 të KSHA-së në lidhje me shqyrtimin e ankesës, referuar të cilit autoriteti kontraktor ka vendosur pranim të pretendimeve të ngritura në ankesë duke vendosur Anulimin e procedurës së prokurimit.

III.1.3.1. Me shkresën me Nr. 359/6 prot., datë 03.03.2026, drejtuar Autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi informacion në lidhje me vënin në dijeni operatorin e interesuar për Vendimmarrjen e KSHA-së , Mbi pranimin e pretendimeve të ankimuesit.

III.1.3.2. Me shkresën ardhur me shërbim postar me nr.621/6 prot, datë 13.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 359/7, datë 19.03.2026 autoriteti kontraktor informon se ka përcjellë vendimin e KSHA-së për operatorin ekonomik të interesuar “InfoSoft Office” ShPK, vërtetuar me fotokopje të fletës së Regjistrit të dorëzimit në postë, nga ku rezulton se me datë 11.03.2026, AK ka postuar shkresën nr. 621/5, me objekt: Përcjellje Vendimi mbi pranimin e pretendimeve të ankimuesit, drejtuar operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK, subjekt i interesur në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.3.3. Në përgjigje të shkresës së KPP-së nr. 359/8 Prot., datë 26.03.2026, drejtuar operatorit ekonomik të interesuar, “InfoSoft Office” ShPK, ka kthyer përgjigje me shkresë ardhur pranë KPP-së, protokolluar me tonën me Nr. 359/19, datë 31.03.2026 në lidhje me datën e marrjes dijeni për Vendimmarrjen e KSHA-së mbi pranimin e Pretendimeve të ankimuesit për Anulimin e Procedurës së Prokurimit: [...] Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se shkresa me Nr. 621/5, datë 11.03.2026 ka mbërritur pranë zyrave tona me anë të Posta Shqiptare me datë 13.03.2026. Bashkëlidhur kopje e librit të postës për marrje në dorëzim nga “InfoSoft Office” ShPK, të dokumentit.[...]

III.1.4. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.5. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.6. Komisioni nga shqyrtimi i akteve të dosjes administrative vëren, se në përputhje me Nenin 114, pika 5, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 4 të këtij neni.”

Operatori ekonomik i Interesuar, icili ka paraqitur Argumente brenda afatit ka pasur të drejtën e ardhjes me ankesë, brenda afatit 7 ditor, nga marrja dijani e vendimit të KSHA-së mbi pranimin e pretendimeve të ankimesit, Vendim i cili ka çënuar interesat e tij.

III.1.7. Referuar Sistemit Elektronik të Ankesave si edhe shkresës së ardhur nga operatori ekonomik i interesuar “InfoSoft Office” ShPK rezulton se ka marrë dijani për Vendimin e KSHA-së në datë 13.03.2026.

Përsa më sipër Komisioni konstaton, se operatori ekonomik i interesuar nuk ka paraqitur ankesë brenda afatit 7 ditor nga marrja dijani e Vendimit të KSHA-së, në përmbushje të nenit 114 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK, nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit brenda afateve të parashikuara në nenin 114, pika 5, të ligjit “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Në përfundim, të shqyrtimit të informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, mbi pranimin e ankesës dhe në zbatim të nenit 115 pika 3/b) të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku citohet: “3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik: b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor”, Komisioni i Prokurimit Publik vendos të mbyllë çështjen në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimes “PC STORE” ShPK, për sa kohë autoriteti kontraktor ka pranuar plotësisht ankesën e tij, duke përmbushur qëllimin e ankimesit mbi anulimin e procedurës objekt shqyrtimi dhe operatori ekonomik i interesuar “InfoSoft Office” ShPK, që ka paraqitur argumente, nuk ka paraqitur ankesë, në zbatim të nenit 114 pika 5, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik “PC STORE” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-65137-10-15-2025, me objekt: Shërbim printimi, me fond limit 2,500,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.12.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë
2. Autoriteti kontraktor të vijojë me hapa të mëtejshëm procedurën e prokurimit sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës që të kthejë tarifën financiare të paguar nga operatori ekonomik “PC STORE” ShPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anëtar

Gjergj Mersini

Anila Malaj

Nënkryetar

Fiorent Zguro

